

1 E hënë, 26 qershor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 10.10

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëdita dhe mirë se keni ardhur.

7 Znj. Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqitni lëndën.

8 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar
9 Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-04, Prokurori i
10 Specializuar kundër Pjetër Shalës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Pikë së pari, u lutem të pranishmëve që të prezantohen.

14 Znj. Prokurore, keni fjalën.

15 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.

16 Për ZPS-në, Line Pedersen, menaxheren e lëndës; Federica
17 Genovesi dhe Grace Kier, stazhierë të brendshëm; De Minicis,
18 Prokuror; dhe unë Gaia Pergolo jam Prokurore.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit.

21 Z. Mbrojtës i Viktimave, keni fjalën.

22 Z. LAWS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës. Jam
23 Simon Laws, Mbrojtësi i Viktimave, së bashku me
24 bashkëmbrojtësen Maria Radziejowska.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Ju lutem, z. Avokat Mbrojtjes, keni fjalën.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës. Më
4 quajnë Jean-Louis Gilissen. Jemi këtu me z. Shala, që ndodhet
5 në qendrën e paraburgimit, na ndjek prej andej. Jam së bashku
6 me dy bashkëmbrojtësit, z. Aouini dhe znj. Cariolou; pastaj
7 Juliette Healy, ndihmëse për shqyrtimin e provave; Judit
8 Kolbe dhe znj. Petravica, menaxhere e çështjes. Faleminderit.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Mirëdita, z. Shala. Më konfirmon, ju lutem, nëse më dëgjoni
11 mirë?

12 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Mirëdita. Ju ndëgjoj
13 shumë mirë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Faleminderit.

16 Sot do të vijojmë me prezantimin e provave nga ZPS-ja.
17 Konkretisht do të dëgjojmë dëshminë e z. Marek Gasior, që
18 është dëshmitar me cilësinë e ekspertit.

19 Përpara se të fillojmë me dëshminë e dëshmitarin, duhet
20 që të trajtojmë disa çështje procedurale që kanë mbetur ende
21 pa marrë zgjidhje. Së pari, Trupi Gjykes do të përfshijë në
22 dokumentacionin gjyqësor një urdhër të dhënë me postë
23 elektronike javën që shkoi, të hënën, 19 qershor 2023, lidhur
24 me përdorimin e mjeteve pamore nga dëshmitari.

25 Pasi mbajtëm shënim kërkesën e ZPS-së të bërë me postën

1 elektronike më 19 qershor 2023, në orën 15.18, për ta
2 autorizuar dëshmitarin që të sjellë në sallën e gjyqit dhe të
3 përdorë gjatë dëshmisë si ekspert një skelet dhe modele
4 anatomike si ndihma pamore, si mjete pamore dhe pasi mbajtëm
5 shënim faktin se Mbrojtja dhe Mbrojtësi i Viktimave nuk kanë
6 paraqitur kundërshtime, Trupi Gjykses e ka miratuar kërkesën e
7 ZPS-së me postë elektronike të datës 19 qershor 2023, të orës
8 15.59 dhe ka autorizuar z. Gasior që të sjellë në sallën e
9 gjyqit dhe të përdorë gjatë dëshmisë së tij si ekspert mjetet
10 pamore të kërkuara.

11 Këtu mbyllet ky urdhër i Trupit Gjykses.

12 Së dyti, Trupi Gjykses sqaron se fillimi i paraqitjes së
13 provave nga ana e Mbrojtësit të Viktimave dhe çdo pikëpamje
14 dhe shqetësim të viktimave pjesëmarrëse, është vendosur,
15 parimisht, në varësi të hapave të tjerë proceduralë, pra,
16 është vendosur për ditën e hënë, datë 21 gusht 2023.

17 Në fund, Trupi Gjykses do të trajtojë çështjen e takimit
18 të zhvilluar dje midis z. Gasior dhe përfaqësuesve të ZPS-së.
19 Fillimisht dëshiroj t'ua jap fjalën palëve dhe Mbrojtësit të
20 Viktimave, për këtë çështje nëse dëshirojnë që të bëjnë
21 parashtrime.

22 Z. Avokat i Mbrojtjes, keni kërkuar fjalën për të bërë
23 parashtrime.

24 Keni fjalën.

25 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mirëdita.

1 Kam dy kërkesa për t'i bërë gojarisht lidhur me situatën.

2 Do të flas në seancë publike.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
4 rregull. Vetëm duhet të tregojmë kujdes nëse ka diçka që duhet
5 ta trajtojmë në çështje private.

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, duke pasur parasysh që
7 dëshmitari nuk ka masa mbrojtëse.

8 Unë dua të lexoj se dua që të mos flasë gjatë.

9 Të nderuar Gjykatës, ne u habitëm shumë, që dje pas dreke
10 u informuam dhe morëm një kopje të një Shënimi Zyrtar të
11 takimit me z. Gasior, lidhur me një takim të zhvilluar dje
12 midis këtij dëshmitari me cilësinë e ekspertit dhe ZPS-së. I
13 ashtuquajhuri shënim ka të bëjë me një intervistë apo një
14 deklaratë të re me këtë dëshmitar. Kjo intervistë nuk ishte në
15 listën e materialeve që i është dhënë Mbrojtjes nga ZPS-ja të
16 premtën, datë 23 qershor 2023.

17 Mbrojtja vëren rëndësinë e kërimit dhe gjetjes së të
18 vërtetës. Mbrojtja, gjithashtu, vëren edhe gjetjet përkatëse
19 në vendimin për familjarizimin e dëshmitarëve që Trupi Gjykes
20 e ka nxjerrë më 24 shkurt 2023.

21 Megjithatë, dhënia e materiale nga një dëshmitar ekspert
22 në prag të dëshmisë së tij është në shkelje të të drejtave të
23 akuzuarit.

24 Edhe një herë, Mbrojtja gjendet përpara një fakti të
25 kryer. Ne sot fillojmë me dëshminë e dëshmitarit, kështu që

1 Mbrojtjes nuk i është dhënë kohë që të shqyrtojë siç duhet
2 elementet e dëshmisë së këtij dëshmitari si ekspert. Ne nuk
3 kemi pasur thujtë as kohë që të marrim udhëzimin nga z. Shala
4 lidhur me këto elemente të reja. Është e papranueshëm. Por më
5 shumë se e papranueshme, është e padrejtë.

6 Kjo e vendos barrën në mënyrë të tepruar mbi Mbrojtjen
7 dhe hyn në të drejtat e Mbrojtjes për t'u përgjigjur në mënyrë
8 efektive dhe për të kundërshtuar provat që janë të paraqitura
9 nga Prokuroria në bazë këtyre provave duke pasur kohë dhe
10 mjete të përshtatshme.

11 Ky ndryshimi i minutës së fundit bie ndesh me parimin e
12 barazisë së palëve dhe bie ndesh me të drejtën e të akuzuarit.
13 Mbrojtja nuk mund të vazhdojë në këtë mënyrë. Parimi bazë i
14 drejtësisë kërkon që Mbrojtjes t'i jepet mundësi reale për të
15 diskutuar, pra, elementin e ri në dëshminë e këtij dëshmitari
16 dhe të marrë udhëzimet e duhura nga klienti. Kjo bën pjesë
17 edhe në udhëzimet e dhëna nën kornizën ligjore të nxjerrë në
18 30 prill 2021.

19 Ne e kemi marrë vendimin që është lëshuar ditën e premte,
20 të nderuar Gjykatës. Nuk e di nëse kjo është një temë tjetër
21 mbase për këtë temë që folëm duhet të ndalojmë këtu. Dhe
22 pastaj dëshiroj të marr fjalën sërish që të flasë për atë
23 çështje.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit, z. Avokat.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Edhe diçka tjetër, sigurisht.

2 Dëshiroj që ta mbyll.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Patjetër. Ju lutem në parashtrimet tuaja mund të përfshimi dhe

5 diçka. Për të cilat elemente të reja, konkretisht bëhet fjalë

6 nga ana juaj.

7 Z. GILISSEN: [Përkthim] E kuptoj.

8 Sipas mendimit, tonë ka informacione të reja, disa

9 hollësi të shënuara në këtë shënim, të ashtuquajtur shënim.

10 Faqja numër 1 e këtij shënimi, pika 4 nga fundi. Kur flitet

11 për dëmin e shkaktuar nga tre plumba. Deri tani eksperti

12 fliste për dy plumba dhe mbase tre. Por kemi dhe renditjen

13 kohore të të shtënave me armë. Eshtrat që janë dëmtuar. Koha e

14 lëndimit dhe shkakut i vdekjes është sigurisht diçka shumë e re

15 për ne. Dhe, nëse mund, mbase në këtë mund ta trajtojmë me

16 këshillin e ekspertëve tanë.

17 Përputhshmëria me faktin që viktimi ka qenë i ulur kur

18 është gjuajtur me armë, është qëlluar me armë pra. Duhet të

19 kthehemi në faqen 16 lidhur me një copëz eshtre. S'po flasim

20 për të njëjtën viktimë. Po flasim për tjetrën. Ky është një

21 informacion i ri. Pra, copëza është, në fakt, copëza fisheku.

22 Pra, është e pamundur të dimë nëse mund të ketë ecur disa ditë

23 pas lëndimit të shputës së këmbës dhe, në fakt, mund të ketë

24 qenë një plagë sipërfaqësore.

25 Pra, të gjitha këto, sigurisht, na duhet që t'i

1 diskutojmë me ekspertin tonë po edhe me z. Shala për marrë
2 prej tij mandatin, lejen, pra, për të parashtruar gjëra para
3 Trupit Gjykues.

4 Prandaj, këto janë gjërat që i quajmë elementë, të cilat
5 na japin të drejtë për kohë të mjaftueshme për të përgatitur
6 kundrapyetjet tona për ekspertin, dëshmia e të cilit është
7 parashikuar për sot. Kjo duke pasur parasysh edhe ndryshimet e
8 bëra në momentin e fundit në dëshminë e këtij dëshmitari të
9 cilat na duhet t'i përpunojmë, t'i analizojmë dhe t'u
10 përgjigjemi. Mbrojtjes i duhet dhënë edhe aktekspertiza
11 plotësuese në mënyrë që të trajtojnë këto elemente të reja për
12 të cilat mësua në shënimin e takimit të djeshëm.

13 Faleminderit shumë për vëmendjen tuaj.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Faleminderit. Faleminderit shumë.

16 Thatë që keni nevojë për kohë të mjaftueshme për të
17 përgatitur kundrapyetjet. Po për sa kohë bëhet fjalë, sa kohë
18 parashikoni që ju nevojitet?

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jemi përpjekur që të kontaktojmë
20 me ekspertin tonë dhe nuk arritëm. Po ishte ditë e diel, e
21 diel pas dreke. Do të përpiqemi sot, po është edhe seanca. Nuk
22 di të them. Mendoj, që një ditë e plotë, nuk do të mjaftonte.
23 Na duhet që të kontaktojmë me ekspertin tonë, ta diskutojmë me
24 atë, pastaj të diskutojmë dhe me z. Shala.

25 Kështu që për mendimin tim 40 orë mund të jetë diçka e

1 dobishme nëse dëshirojmë të shmangim ndonjë problem të ri. Që
2 pastaj t'u kthehemi prapë këtu dhe t'ju themi, oh jo, kemi
3 përsëri një problem. Faleminderit shumë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
5 nëse ju kuptova siç duhet, dëshironi që të merrni dhe shtesën
6 që i është bërë aktekspertizës.

7 A mund të sqaroni më tej se çfarë u duhet shtuar kësaj
8 shtese, pra, këtij materiali shtesë? Se ajo që është diskutuar
9 me sa kam kuptuar është përfshirë në këtë shënim.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Absolutisht, e nderuar Gjykatëse.

11 Por nuk e dimë pse, nuk dimë shkakun, pra, s'dimë arsyen,
12 s'dimë shkakun, pasojat dhe nuk dimë as përse-në nëse mund ta
13 them kështu. Kështu që dëshirojmë që të kemi edhe elementet
14 teknike. Shpresoj që do të jemi në gjendje që të kuptojmë
15 përfundimet, këto mendoj se i kuptojmë, po jo mënyrën me të
16 cilën eksperti i ka dhënë këto informacione të reja sepse pa e
17 pasur e të plotë ekspertizën, ne nuk mund të dimë sesi
18 funksionon kjo. Dhe kjo s'na jep neve mundësi që të dalim në
19 përfundime apo të kuptojmë sesi është dalë në përfundimet e
20 reja, megjithatë, kjo nuk përputhet ekzaktësisht me
21 përfundimet që na ka dhënë eksperti juaj.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,
23 eksperti do jetë këtu.

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] E kam fjalën për ekspertin tonë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,

1 eksperti këtu do jetë, ky ekspert që do jap dëshminë. Pra,
2 gjithçka është nxjerrë. Unë nuk kam marrë asnjë kërkesë që do
3 të përdoret ky shënim në sallë, të paktën më për më s'kam
4 marrë gjë.

5 Ju mund t'i bëni këto pyetje, mund t'ia bëni ekspertit.
6 Po jua them këtë si Trupi Gjykues.

7 Do t'ia jap tani fjalën ZPS-së dhe Mbrojtësit të
8 Viktimave.

9 Keni fjalën, znj. Prokurore.

10 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
11 Gjykatëse.

12 Dua që të ngre dy pika lidhur me kundërshtimin e
13 Mbrojtjes.

14 Pikë së pari, vendimi mbi familjarizimin e dëshmitarëve
15 që është parashtrimi i protokolluar 435, përcakton edhe
16 kontaktet përkatëse nga e ana e palës që thërret dëshmitarin.
17 Dhe paragrafi 19 i këtij vendimi thotë dhe po citoj se:

18 "Diskutimet ndërmjet palës thirrëse dhe dëshmitarit
19 ekspert mund të zhvillohen në çdo moment përpara thirrjes së
20 këtij dëshmitari".

21 Pra, ndryshe nga dëshmitarët e faktit, nuk ka kufizime të
22 vendosura mbi ZPS-në, që subjekti thirrës në këtë rast, që të
23 takohet me ekspertin e vet përpara fillimit të dëshmisë.

24 Gjatë takimit të djeshëm, ne thjesht kemi kërkuar sqarime
25 sa i takon konstatimeve të bëra në aktekspertizë, të cilën

1 Mbrojtja e ka pasur prej kohës dhe ne nuk diskutuam çështje të
2 reja, diskutuam për çështje që nuk janë të reja. Ideja ishte
3 që dëshmia të ishte më efikase dhe më e qartë.

4 Sigurisht, janë trajtuar dhe probleme që kanë dalë për
5 dëshmitë dhe provat e paraqitura deri tani. Kjo me idenë e
6 thjeshtimit të procesit deri tani.

7 Kjo është në të drejtat e ekspertit tonë për të diskutuar
8 për këtë çështje. Kemi mbajtur shënime nga ky takim, të cilat,
9 me gjithë respektin, nuk është aktekspertizë por është një
10 Shënim Zyrtar. Menjëherë kemi informuar Mbrojtjen, Trupin
11 Gjykues, të gjitha palët dhe kjo bën pjesë në të drejtat tona.

12 Mbrojtja është ankuar dhe për një shkelje sistematike të
13 të drejtave të tyre, por nuk mendojmë se ka pasur një shkelje
14 të tillë. Mbrojtja nuk ka arritur të dëshmojë një dëmtim që i
15 është bërë nga takimi ynë me ekspertin në fjalë z. Gasior.
16 Pra, sigurisht, nëse ka probleme që dalin mund të trajtohen si
17 gjatë pyetjeve që ia bënë pala thirrëse ashtu edhe gjatë
18 kundrapyetjeve.

19 Ky është qëndrimi ynë i tanishëm. Faleminderit.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit, znj. Prokurore.

22 z. Mbrojtësi i Viktimave, keni fjalën.

23 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

24 Shumë shkurt. Pikë së pari, ne jemi dakord me ZPS-në që
25 një takim i tillë nuk është i kundërshtueshëm dhe sigurisht

1 nuk përjashtohet nga vendimi për informimin e dëshmitarëve.

2 U tha këtu që është në prag të dhënies së dëshmisë. Nëse
3 gjatë këtij takimi dalin tema të reja, atëherë nuk e ka fajin
4 ZPS-ja. Është një fakt që ka dalë si rezultat i faktit se
5 eksperti ka dashur që të sqarojë gjëra nga aktekspertizat e
6 mëparshme.

7 Nëse bëhet fjalë për çështje të reja që e kanë befasuar
8 Mbrojtjen, nuk mund të komentoj. Mund të them vetëm kaq që për
9 aq sa ka probleme të reja të ngritura për aktekspertizë, nuk
10 besoj se ne kemi nevojë për kohë shtesë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Faleminderit, z. Mbrojtës i Viktimave.

13 Z. Avokat i Mbrojtjes, nëse keni nevojë për një raund të
14 dytë.

15 Z. GILISSEN: [Përkthim] Shumë shkurt.

16 Shpresoj që të mos jetë marrë që ne quhet se po ankohe mi
17 për shkelje sistematike. Shpresoj të mos jetë kështu.

18 Neve, sigurisht, në këtë rast jemi dëmtuar, jemi palë e
19 dëmtuar. Jemi plotësisht në një çështje teknike. E kemi të
20 nevojshme të kemi ndihmë dhe të kemi kontakt me ekspertin
21 tonë. Nëse duam që të kuptojmë dhe nëse duam që të bëjmë
22 kundrapyetje të dobishme dëshmitarit, nëse duam që të jemi
23 palë plotësisht si Mbrojtje, na nevojitet ky kontakt.

24 Këtu do të doja që të fokusohesha në fillim. Por desha
25 dhe të korrigjoj atë pra, që ne nuk po pretendojmë gjëra të

1 tmerrshme si e drejta e Mbrojtjes e kështu me radhë. Nuk është
2 zakoni i ynë ky, nuk e kemi për zakon, për huq, që të ankohe mi
3 më kot.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
5 Avokat i Mbrojtjes, lidhur me këtë të fundit, po na thoni se
6 nuk është qëndrimi i Mbrojtjes se ka një shkelje strukturore
7 ndaj të drejtave të Mbrojtjes në këtë rast.

8 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ne kështu mendojmë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
10 që nuk ka shkelje sistematike, por se në këtë rast mendoni se
11 janë shkelur të drejtat, por ju nuk deshët të thoni se ka
12 pasur një shkelje strukturore.

13 Z. GILISSEN: [Përkthim] Për t'ju përgjigjur pyetjes suaj,
14 dje u përpoqëm që të rishkruajmë disa pyetje me informacion të
15 ri, përfshirë dhe shënimet. Mund të them se është e vështirë
16 dhe sipas mendimit tim mund të ketë një rrezik, shpresoj që e
17 kuptoni qëndrimin tonë që do të kuptojmë plotësisht gjithë
18 këto elementet e reja.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
20 Prokurore, ka ndonjë gjë që doni të shtoni?

21 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Avokati i Viktimave?

24 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë për shtuar.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Atëherë ajo çfarë do bëjmë është që së pari do t'ju jap fjalën
2 juve, Avokat i Mbrojtjes, në mënyrë që të ngrini pikën e dytë
3 që dëshironi që të sillni në vëmendjen tonë. Do të diskutojmë
4 ndërmjet nesh lidhur me pikën e parë dhe pastaj do ju themi
5 sesi do ju themi sesi do procedojmë më tej.

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] Shumë mirë faleminderit, të
7 nderuar Gjykatës.

8 Mbrojtja u njoftua të premtën që nuk do t'i lejohet që të
9 bëjë kundërpyetje dëshmitarit të Prokurorisë që pritet që të
10 japë dëshminë e vetë përpara këtij Trupi Gjykues. Ne mendojmë
11 që kjo është cenuese për ne. Njoftimi i vonuar i këtyre
12 ndryshimeve, po ashtu, ka ndikim për mënyrën sesi ka
13 përzgjedhur Mbrojtja që të konfrontojë dëshmitarët e mëparshëm
14 dhe mendojmë që kjo është cenuese për Mbrojtjen.

15 Dhe mendojmë, që ndryshimi i Prokurorisë, në momentin e
16 fundit, do të thotë që Mbrojtjes i mohohet koha e vlefshme, që
17 asaj i duket absolutisht e nevojshme, në mënyrë të tillë që të
18 shtojë elementë të prezantimit të çështjes së vetë.

19 Çdo vendim i kërkesës së Mbrojtjes për autorizim për
20 apelim, ky vendim do të nxirret pas përfundimit të çështjes së
21 Prokurorisë. Sipas nesh, kjo nuk mund të jetë e pranueshme.
22 Kështu që duhet që të duhet që të bëhet një planifikim i ri
23 lidhur me mënyrën sesi do procedohet më tej me procesin
24 gjyqësor. Ne mendojmë që situata dhe procedura e apelit kanë
25 ndikim mbi produktivitetin e Mbrojtjes.

1 Kështu që, kërkesa jonë është që çështja e Prokurorisë
2 mund të shqyrtohet vetëm në qoftë se ka elementë të rinj,
3 sigurisht, domethënë, pasi është marrë vendimi përkatës për
4 autorizim të apelit. Dhe, sipas nesh, ne parashtrojmë përpara
5 Trupit Gjykues se deri tek lëshimi i këtij vendimi do të duhet
6 kohë.

7 Faleminderit për vëmendjen.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Transkripti nuk është i plotë. Ju kërkoj ndjesë për këtë.

10 A mund të na thoni, ju lutem, se deri në çfarë kohe
11 kërkonti që çështja e ZPS-së të mos mbyllet, se nuk ishte e
12 qartë nga transkripti?

13 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mund ta lexoj dhe një herë.

14 Atëherë në përfundim, çështja ose provat e Prokurorisë
15 mund të konsiderohen të mbyllura vetëm atëherë kur Trupi
16 Gjykues të ketë vendosur për kërkesën e Mbrojtjes për leje për
17 apelim të vendimit dhe deri sa të lëshohet vendimi i apelit,
18 në qoftë se doni që të parashikoni mundësinë e mundshme të
19 apelit dhe, në qoftë se kjo procedura e pyetjeve do jetë
20 tërësisht e dobishme.

21 Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
23 kuptoni sesa kohë do të kërkonte kjo apo jo?

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Më besoni, kemi hezitur shumë që
25 të flasim në lidhje me këtë problem. Megjithatë, ne e

1 konsiderojmë që ky është një problem ekzistues, është i
2 vërtetë dhe i rëndësishëm. E kuptojmë plotësisht situatën. Por
3 është një çështje e dhimbshme. Është një çështje e rëndësishme
4 për të gjithë neve. Por, megjithatë, ky është realiteti. Ky
5 është realiteti me të cilin ne hasemi, kështu që mendoj që
6 gjëja më e mirë që të themi apo të bëjmë është që t'ju japim
7 një zgjidhje dhe mendojmë që kjo është zgjidhja më e
8 përshtatshme.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
10 rregull. E kuptoj, thjesht, doja që të kuptoheshim qartë edhe
11 që ndanim të njëjtin opinion të dyja palët.

12 Znj. Prokurore, e keni ju fjalën.

13 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Shumë shkurtimisht. Ne nuk
14 mendojmë që ekzistojnë arsye për ndryshimin e hapave
15 procedurale të përcaktuara nga Trupi Gjykes gjatë vitit të
16 fundit ose përmes vendimit tuaj të 16 qershorit.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
18 rregull.

19 Z. Laws.

20 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të shtuar lidhur
21 me këtë çështje.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Trupi
23 Gjykes do të këshillohet. Do të diskutojë për pikën e parë që
24 ngritët përpara Trupit Gjykes. Ndërkohë që sa i takon
25 çështjes së dytë, do t'ju jap një përgjigje më pas. Megjithatë

1 shpresojmë, domethënë, që kuvendimi midis nesh mos të kërkojë
2 më shumë kohë sesa nevojitet.

3 Në rregull. Do të bëjmë një pushim tani.

4 --- Pauza fillon në orën 10.39

5 --- Seanca rifillon në orën 11.10

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
7 se erdhët. Mirë se u kthyet.

8 Sa i takon kërkesës së parë të bërë nga Avokati i
9 Mbrojtjes, ajo çfarë do të bëjmë është si më poshtë. Do të
10 nisim sot me marrjen në pyetje të dëshmitarit nga Prokuroria
11 dhe me marrjen në pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave, në qoftë
12 se do ketë pyetje prej tij. Sigurisht, që nuk është detyra e
13 Trupit Gjykses që të ndërhyjmë me organizimet e brendshme të
14 Mbrojtjes, por Trupi Gjykses sugjeron që të kontaktoni sot në
15 momentin më të parë të mundur me ekspertin, domethënë, një
16 prej Mbrojtjes të mund të kontaktojë me ekspertin. Dhe pastaj
17 nesër do të fillojmë me marrjen në pyetje të Mbrojtjes
18 mbasdite, pra, në orën 1.30, nesër pasdite. Dhe do të
19 organizojmë dy seanca, pra, do të organizojmë një seancë nga
20 ora 1.30 deri në 3.00 pasdite, pastaj do të bëjmë një pushim
21 prej 30 minutash dhe pastaj do të punojmë deri në orën 5.00.
22 Për ditën e sotme, ajo çfarë do të bëjmë është që do të
23 vazhdojmë deri në orën 12.30. Pastaj do të bëjmë një pushim
24 prej një ore për pushimin e drekës. Pastaj do të organizojmë
25 një seancë prej një ore e gjysëm, gjysmë ore pushim dhe pastaj

1 30 minuta punë dhe do të punojmë, pra, deri në orën 4.00 sot.
2 Synimi është që të përfundojmë me pyetjet e Prokurorisë dhe
3 pyetjet e Mbrojtësit të Viktimave. Dhe nëse do të rezultojë që
4 gjërat do të shkojnë ndryshe, atëherë do të bëjmë do të
5 kontaktojmë me shërbimin e përkthimit për të parë në qoftë se
6 përkthyesit do të jenë të disponueshëm për të na ndihmuar më
7 tepër, pra, përtej kësaj ore. Pra, është e rëndësishme për
8 neve që të përfundojmë me pjesën e parë, pra, me marrjen në
9 pyetje nga Prokuroria dhe Mbrojtësi i Viktimave, në mënyrë të
10 tillë që të keni kohën në dispozicion dhe që mund të vijoni më
11 tej me kontaktimin e ekspertit.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] A mund të flas?

13 Më lejoni të bëj një sqarim, të nderuar Gjykatës.

14 Në transkript, në faqen 11 dhe 12, pra, sikurse mund ta
15 kuptoni, ne nuk është, pra, nuk pretendojmë që kemi të bëjmë
16 me shkelje të të drejtave të z. Shala. Më kërkua që të jepja
17 mendimin tim sa i takon, pra, shkeljes strukturore të të
18 drejtave të z. Shala. Dhe unë u përgjigja në përgjigjen tuaj
19 që ne nuk e konsiderojmë që ky rast specifik tregon një
20 shkelje strukturore të të drejtave të z. Shala në këtë proces
21 gjyqësor. Dhe ne e kemi përsëritur në mënyrë të vazhdueshme në
22 parashtrimin tonë dhe do ta themi sa herë që të jetë e
23 nevojshme.

24 Domethënë, ky është një rast i izoluar. Është njoftim i
25 vonuar i një dokumenti për Mbrojtjen. Dhe kjo, pra, domethënë,

1 këtë mendoj, këtë përgjigje e dhashë edhe më përpara dhe mbase
2 mendoj që ishte me të drejtë që ta theksoj dhe njëherë
3 pozicionin tim. Domethënë, që nuk mendojmë që ka shkelje
4 strukturore të ë drejtave të të akuzuarit.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
6 mbajtëm shënim. Faleminderit, Avokat.

7 Tani, do të vazhdojmë, megjithatë, ka edhe një çështje
8 tjetër që doja ta sjellja në vëmendjen tuaj, përveç asaj që
9 sapo shpjegova sa i takon mundësisë së zhvillimit të ditës së
10 sotme e ditës në vijim dhe faktin që kemi planifikuar kohën në
11 dispozicion për Mbrojtjen duke i dhënë asaj më tepër kohë,
12 pra, për të bërë pyetjet, për të formuluar pyetjet për
13 dëshmitarin dhe dëshiroj që të theksoj që sipas paragrafit që
14 u përmend nga ZPS-ja që ka të bëjë me vendimin për njohjen e
15 dëshmitarit, kufizimi i përmbajtjes ndërmjet palës thirrëse
16 edhe dëshmitarit nuk aplikohet për ekspertët që vijnë për të
17 dhënë dëshmi këtu. Domethënë, ky është përjashtimi. Trupi
18 Gjykues nuk shikon shkelje për sa i takon procedurës së
19 familjarizimit të dëshmitarëve të parashikuar në vendimin
20 përkatës të Trupit Gjykues.

21 Pra, kemi përfunduar me komentet e Trupit Gjykues. Dhe
22 tani kemi ardhur në momentin ku do të fillojmë me dëshminë e
23 ekspertit Gasior. Z. Gasior do të japë dëshmi pa masa
24 mbrojtëse. Megjithatë, siç ka ndodhur dhe më përpara një pjesë
25 e dëshmisë së tij mund të jepet në seancë private dhe në qoftë

1 se kjo është e nevojshme, për shembull, për të mbrojtur
2 identitetin e dëshmitarëve ose viktimave ose personave të
3 tjerë me interes për këtë proces gjyqësor.

4 Ju thashë se gjatë cilave seanca do të punojmë sot. Ju
5 falënderoj.

6 Dhe dua që t'i kërkoj Sekretares që të sjellë dëshmitarin
7 në sallën e gjyqit për momentin.

8 Z. Shala, ngrite dorën? Nuk ju dëgjojmë, z. Shala.

9 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, e nderuar Gjyqtare.
10 Unë, e nderuar Gjyqtare, unë nuk jam jurist, po unë nuk e kam
11 kuptu as çka është bë ndryshimi. Po unë mendoj, simbas ligjit
12 që më takon, ta kuptoj çka është bë, çfarë ndryshimi është bë
13 dhe duhet të më vjen mu ta kuptoj se çka është në lidhje me
14 çka bëhet fjalë.

15 As nuk kam konsultim me avokatë, as nuk jemi konsultu as
16 nuk më është sqarue se çka çfarë ndryshimi ka deklarata e
17 dëshmitarit të sotëm, dje, çfarë ndryshimi ka? Asgjë. Nuk jam
18 në rrjedha. Mendoj se është e drejtë e imja që të jem i
19 njoftum. Së paku të jem i njoftum lidhur me çka edhe se jeta
20 ime është në pyetje këtu. Ju faleminderit.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Faleminderit, z. Shala.

23 Avokat, jua lë në dorë ju që të bëni kërkesa lidhur me
24 këtë. Ne e morëm, jua lexuam dhe jua dhamë vendimin tonë, pra,
25 e kemi marrë parasysh kërkesën e ngritur prej jush. Kështu që

1 nuk e di se çfarë pozicioni keni ju lidhur me këtë pikë?

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Qëndrimi im, është ajo që ju
3 shpjegova pak më përpara, pra, unë ju shpjegova që kemi
4 probleme me përmbajtjen e re, domethënë, por nga ana tjetër
5 është e nevojshme që të kemi kontakt me ekspertin, por, së
6 pari, duhet të kemi kontakt me z. Shala. Sepse, z. Shala,
7 duhet të jetë i informuar për të gjitha pasojat, pra, duhet të
8 jetë i informuar për përmbajtjen e deklaratës së re.

9 Dhe e kuptoj plotësisht reagimin e z. Shala. Nuk është
10 jurist, z. Shala, megjithatë ndërhyrjen e kishte me shumë
11 vend. Kështu që, unë mendoj, që neve duhet të na jepet kohë në
12 dispozicion në mënyrë të tillë që të kontaktojmë me z. Shala.
13 Sipas mendimit tim, përpara sesa të dëgjojmë dëshminë e
14 dëshmitar sot është e nevojshme që të flasim me z. Shala.

15 Kështu që unë kërkoj që të shtyjme fillimin e deklaratës
16 së dëshmitarit për seancën e pasdites. Në mënyrë të tillë që
17 të kemi mundësi që të shkojmë në mënyrë të drejtpërdrejtë në
18 qendrën e ndalimit në burg, aty ku është z. Shala, mendoj që
19 është me vend që të shtyhet seanca dhe ta realizojmë seancën
20 në mënyrë të duhur ose pothuajse në mënyrën e duhur, pra,
21 është e nevojshme për ne që të kontaktojmë me klientin tonë.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo
23 çështje nuk është ngritur më përpara. Se ju bëtë një kërkesë
24 më përpara, por kjo nuk është diçka që e përfshitë në kërkesën
25 tuaj, nuk e na e kërkuat, nuk ia kërkuat Trupit Gjykses. Ose

1 të paktën unë nuk e kam kuptuar që na e kërkuat këtë gjë.

2 Megjithatë, do të kërkojmë dhe palët e tjera dhe do të
3 vendosim.

4 Z. GILISSEN: [Përkthim] Unë fillova që të them që është e
5 nevojshme për ne që të flasim me ekspertin edhe me z. Shala.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
7 juve një kopje e deklaratës që ju dha dje apo jo?

8 Z. AOUBINI: [Përkthim] Për të shtuar. Për një çështje
9 teknike. Të dielën ne nuk kontaktojmë dot me qendrën e
10 ndalimit që të kemi kontakt me z. Shala.

11 Pra, e vetmja gjë që mund -- e vetmja kohë kur mund të
12 flisnim me z. Shala ishte sot dhe në qoftë se do të ishte në
13 sallë do të diskutonim me z. Shala se cila ishte situata duke
14 marrë parasysh kohën në dispozicion, ne nuk mund të
15 kontaktojmë me z. Shala në mënyrë të drejtpërdrejtë. Së pari
16 na duhet që të kontaktojmë me qendrën e burgimit dhe pastaj
17 punonjësit e qendrës aty kontaktojnë me z. Shala për të
18 kontaktuar me neve. Kështu që mundësia më e hershme për neve
19 ka qenë në orën 8.30, kur folëm në telefon me z. Shala. Por
20 ishte e pamundur për neve që të kishim kontakt me të gjatë
21 fundjavës. Në fundjavë nuk kontaktojmë dot, pra, të shtunën e
22 të dielën nuk kontaktojmë dot, ditët e javës kontaktojmë deri
23 në 5.30. Z. Shala nga ana tjetër mund të kontaktojë me ne, por
24 në qoftë se ne duam të flasim me z. Shala, pra, duhet që të
25 flasim me të.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pas
2 orën 5.30?

3 Z. AOUINI: [Përkthim] Nuk kontaktojmë dot pas orës 5 e 30
4 gjatë ditëve të javës. Ndërkohë që në fundjavë nuk kontaktojmë
5 dot fare. Sepse kemi provuar që të kontaktojmë ndonjëherë dhe
6 nuk ka nëpunës aty, kështu që nuk kontaktojmë dot. Kështu që
7 z. Shala mund të na kontaktojë ne, po ne nuk e kontaktojmë dot
8 atë, domethënë, në qoftë se është për orën 9.00 ose përtej
9 orës 5.30.

10 Domethënë, me fjalë të tjera, ishte e pamundur për ne që
11 të kishim kontakt me burgun në mënyrë të tillë që të mund të
12 kontaktonte një nëpunës i tij me z. Shala. Kontakti i vetëm që
13 kemi pasur ka qenë dje në orën 8.30, që na mori në telefon z.
14 Shala, por nuk kishim kohë në dispozicion sepse na duhej që të
15 udhëtonim.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
17 kisha dashur që të më kishit dhënë pak më shumë informacion,
18 në mënyrë të ta kuptoja të gjithë situatën ashtu siç ishte. Po
19 siç e thashë do bëjmë një tjetër raund do bisedojmë përsëri.

20 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Ne parashtrojmë që nuk ka
21 çështje të reja që kanë dalë nga takimi i ditës së djeshme.
22 Kështu që nuk e shohim se cila është arsyeja që të shtyjmë
23 fillimin e marrjes në pyetje të dëshmitarit. Ndërkohë
24 Mbrojtjes ju dha koha e nevojshme përpara sesa të fillojmë me
25 pyetjet e veta, kështu që mendoj që kjo kohë duhet të jetë e

1 mjaftueshme për Mbrojtjen.

2 Faleminderit.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Mbrojtësi i Viktimave.

5 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të shtuar lidhur
6 me këtë çështje.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Faleminderit, për komentet.

9 Atëherë propozoj që të fillojmë me marrjen në pyetje të
10 dëshmitarit tani vetëm për një orë. Pastaj gjatë pushimit do
11 të keni mundësi që të diskutoni me z. Shala çështjet e reja të
12 ngritura. Nëse Mbrojtja dëshiron që të ketë 30 minuta më
13 tepër, mund ta bëjmë pushim një orë e 30 minuta, në mënyrë të
14 tillë që të paktën të mund të diskutoni çështjet me z. Shala
15 dhe do procedojmë, do vijojmë në këtë mënyrë.

16 Z. Shala, gjatë pushimit, pra, pas një ore do t'ju jepet
17 mundësia të flisni me Mbrojtjen. E di që kjo mundësi mund të
18 organizohet për ju, në mënyrë të tillë që të diskutoni me
19 ekipin e Mbrojtjes tuaj dhe do t'ju jepet kohë gjithashtu edhe
20 pas seancës së ditës së sotme dhe nesër paradite në mënyrë të
21 tillë që të diskutoni.

22 Kështu që tani do t'i kërkoj Sekretares që të sjellë
23 dëshmitarin këtu në seancë.

24 Keni një orë e gjysëm kohë gjatë drekës, pra, që të
25 diskutoni me Mbrojtjen, z. Shala.

1 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Mirëmëngjesi. Uluni, ju lutem.

4 Mirëmëngjes, z. Gasior. Si jeni?

5 Mund të flisni në gjuhën tuaj amtare.

6 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Si

8 jeni?

9 DËSHMITARI: [Përkthim] Shumë mirë. Faleminderit të gjithë
10 pjesëmarrësve. Faleminderit që u kujdesët kaq mirë për mua.

11 Faleminderit personelit që punon këtu në Dhomat e

12 Specializuara.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Faleminderit, z. Gasior. Sot do të fillojmë me dëshminë tuaj.

15 A më dëgjon?

16 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, ju dëgjoj shumë mirë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

18 Shala, po ju e dëgjoni mirë dëshmitarin?

19 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Nuk e dëgjoj

20 dëshmitarin fare.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A kjo

22 është pak problem, se përndryshe nuk punojmë dot kështu, do të

23 thërrasim një teknik që ta shohë çfarë problemi ka, z. Shala.

24 [Trupi Gjykes dhe Sekretarja e Gjykatës

25 këshillohen]

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

2 Gasior, na dëgjoni? A më dëgjon mua?

3 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk ka përkthim.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

5 Shala nuk ju dëgjon, kështu që po shohim çfarë problemi teknik

6 ka, po kontrollojmë pak anën teknike që ta zgjidhim problemin.

7 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës

8 këshillohen]

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do i

10 lutesha përkthyesve të përkthejnë diçka, këto që po them më

11 konkretisht për të kuptuar nëse na dëgjon z. Shala, në qoftë

12 se dëgjon Kryegjykatësen. Pastaj do i lutesha dëshmitarit të

13 thotë diçka.

14 Z. Dëshmitar, sot do fillojmë me dëshminë tuaj. Kjo po

15 bëjmë një provë tani për anën teknike. z. Dëshmitar, sot do të

16 fillojmë me dëshminë tuaj.

17 Z. Dëshmitar, a dëgjoni ju? Ose mund të thoni të paktën

18 "Test, test, test" "Provë, provë, provë".

19 Z. Gasior, a mund të thoni "Test, test, test"

20 DËSHMITARI: [Përkthim] Test, test.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

22 Shala, dëgjove tani kur tha z. Gasior "Provë, provë, provë"

23 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Jo. Nuk ndigjohet.

24 Dëshmitari nuk ndëgjohe fare.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

1 rregull. Duhet ta zgjidhim këtë.

2 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
3 këshillohen]

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
5 bëjmë një ndryshim atëherë. Që të zgjidhim edhe aspektin
6 teknik, unë do propozoj që në vend që rrimë ulur këtu të
7 humbasim kohën, bëjmë pushim tani deri në 1.00. Ndërkohë edhe
8 Mbrojtja diskuton me z. Shala. Zgjidhim dhe problemin teknik.
9 Do flasim dhe me përkthyesit për të parë sa kohë mund të rrinë
10 sot pasdite sepse mendoj që sot është e nevojshme t'i mbarojmë
11 pyetjet nga ana e Prokurorisë dhe nga Mbrojtësi i Viktimave.
12 Kjo është mënyra më e mirë për të vijuar.

13 Z. Gasior, ju kërktoj shumë ndjesë se ju lamë të prisnit
14 paradite ngaqë duhet të diskutonim shumë aspekte, tani kemi
15 një problem teknik. Që do të thotë do ta mbyllim seancën tani
16 dhe do fillojmë në orën 1.00. E keni të qartë.

17 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk ka asgjë problem.
18 Faleminderit.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Atëherë shoqëroni dëshmitarin jashtë sallës së gjyqit.

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Ndërkohë, znj. Prokurore, sa kohë mendoni se do t'i nevojitet
24 Prokurorisë për të bërë pyetjet e veta?

25 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Ne kishim llogaritur tre orë.

1 Kështu që pak a shumë tre orë a diçka më pak. Po gjatë
2 momentit që do bëjmë dhe pyetjet mund të jap edhe një farë
3 përditësimi, por të paktën duhet të fillojmë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Mbrojtës i Viktimave, po ju a mund t'i thoni Trupit Gjykes sa
6 kohë do ju nevojitet?

7 Z. LAWS: [Përkthim] Ose nuk do më nevojitet fare kohë ose
8 shumë pak minuta. Kam vetëm dy aspekte shumë të shkurtra. Po
9 ka mundësi që t'i mbulojë vetë Prokuroria kur të bëjë pyetjet
10 e veta, kështu që s'do jetë nevoja që të pyesim dhe ne.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
12 rregull.

13 Atëherë, z. Shala, gjatë kësaj kohe do keni mundësi të
14 flisni me ekipin tuaj të Mbrojtjes për të gjitha aspektet që
15 keni nevojë të diskutoni dhe ne do të rikthehemi në orën 1.00
16 dhe do të shohim pastaj çfarë orari do të ndjekim për pjesën
17 tjetër të pasdites. Ndërkohë zgjidhim dhe problemin teknik.

18 Seanca ndërpritet.

19 --- Pauza fillon në orën 11.37

20 --- Seanca rifillon në orën 13.08

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
22 se u kthyet. Të shoh një herë në qoftë se kanë ndryshuar
23 ekipet e palëve në sallën e gjyqit. ZPS-ja në të njëjtin
24 persona. Edhe Mbrojtësi i Viktimave dhe në të majtën time.

25 Shpresoj që gjërat të jenë mirë. Po. Më informuan se ka

1 pasur një aksident të vogël, por uroj që gjithçka të jetë
2 mirë. Shoh që pohoni me kokë. Mirë, do të vazhdojmë me
3 dëshminë.

4 Z. Shala, ne na dëgjon?

5 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju dëgjoj shumë
6 mirë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Faleminderit, z. Shala.

9 Përpara se të sjellim dëshmitarin do të doja të jepja
10 disa udhëzime sa i takon përkthimit. Çdo herë që do flasë
11 dëshmitari, na duhen 10 sekonda kohë përpara se të përgjigjemi
12 që të sigurohemi që të ketë mbaruar përkthimi dhe ta dëgjojë
13 z. Shala. Kjo është shumë e rëndësishme. Dhe z. Shala, herët e
14 para, domethënë, kur të flasë në fillim dëshmitari unë do të
15 shoh me sy që të sigurohem që ke marrë përkthimin. Do ju
16 lutesha të ngresh gishtin, të bësh OK, domethënë, ose të ma
17 bësh me shenjë, por mjaft të më ngresh gishtin, të më pohosh
18 që e ke marrë përkthimin. Dhe kur të flasim, kur të hymë te
19 pyetjet nuk është më nevoja, por vetëm fillimisht dua të
20 sigurohem që po e merr përkthimin, sepse kërkon pak kohë nga
21 folësi te përkthimi. A pajohesh, a je dakord kështu?

22 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, unë jam dakord znj.
23 por unë nuk kuptoj. Vetëm një gjë ju lutem, ekspertin e
24 kaluar, ekspertin e kaluar, edhe pse folte në gjuhë tjetër, u
25 ndëgjoke zëni i tina, duke folur dhe përkthimin normal. Kurse

1 këtë sot nuk dëgjohet fare. A flet apo nuk flet? A kullet apo
2 nuk kullet? Kjo nuk është në rregull për mendimin tim.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
4 kuptoj, e kuptoj. Kemi një problem teknik që po përpiqemi ta
5 zgjedhim. Për momentin të ndjekim udhëzimet që sapo ju dhashë.
6 Ne do sigurohemi që ta dëgjosh edhe ekspertin. Ne nuk do
7 vazhdojmë pa e dëgjuar ti ekspertin. Në rregull.

8 Ju lutem, atëherë, sillni dëshmitarin.

9 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Ju lutem, a mund të them diçka
10 shkurtimisht përpara se të vijë dëshmitari?

11 Për të informuar Trupin Gjykses që ne kontaktuar
12 ekspertin tonë gjatë kohës që kishim pushimin dhe e informuar
13 mbi elementet e reja që u diskutuan dje. Ajo nuk është e
14 disponueshme as sot as nesër që të shqyrtojnë materialet e reja
15 dhe që të takohet me ne në mënyrë që edhe ne të bëjmë
16 kundërpjetet tona me dëshmitarin.

17 Prandaj, do ju luteshim të na jepnit një javë kohë që të
18 përgatitemi; të kemi mundësinë të konsultohemi siç duhet me
19 ekspertin tonë; të diskutojmë elementet e reja që kanë dalë
20 dhe pastaj të ballafaqohemi me dëshmitarin.

21 Kjo është kërkesa jonë.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
23 t'i jap mundësinë edhe Prokurorisë edhe Mbrojtësit të
24 Viktimave të bëjmë parashtrimet e tyre në lidhje me këtë pikë.
25 Edhe më pas do të marrim ne vendimin në një moment të

1 mëvonshëm.

2 Atëherë, znj. Prokurore, keni diçka për të shtuar lidhur
3 me kërkesën sapo na u bë nga ekipi i Mbrojtjes?

4 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Shkurtimisht, qëndrimi im është
5 që nuk ka ndryshime. Sqarimet që morëm dje janë në përputhje
6 me materialin dhe informacionet që ka dhënë eksperti më herët
7 dhe ne besojmë se një javë është goxha kohë. Është goxha
8 ndryshim i madh në kalendar për momentin. Plus që edhe ne
9 duhet të shohim a janë përkthyesit në dispozicion. Ka edhe
10 aspekte logjistike që duhen marrë parasysh lidhur me këtë.
11 Kështu që besoj ta shtyjmë me një javë kundërpyetjet është pak
12 e tepërt, duke pasur parasysh çka tha më herët dhe çfarë do të
13 diskutohet me ekspertin.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Faleminderit.

16 Mbrojtësi i Viktimave, fjala është për ju.

17 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të shtuar në
18 lidhje me këtë pikë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ju
20 lutesha atëherë, do ju lutesha të sillnit dëshmitarin në
21 sallën e gjyqit.

22 [Dëshmitari vijon dëshminë]

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
24 Uluni, z. Dëshmitar.

25 Z. Gasiar, tani do të fillojmë me pyetjet, me dëshminë

1 tuaj, pra.

2 Përpara se të fillojmë kam disa udhëzime. Fillimisht
3 dëshiroj t'ju pyes, a më dëgjoni siç duhet?

4 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, ju dëgjoj shumë mirë.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
6 Shala, e dëgjove përgjigjen e ekspertit?

7 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Jo.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
9 Dëshmitar, z. Gasior, ju lutem, a mund ta përsërisni
10 përgjigjen edhe një herë? Mund ta thoni edhe një herë
11 përgjigjen tuaj.

12 DËSHMITARI: [Përkthim] Ku e keni fjalën? Nuk e kuptoj.
13 Doni që të them po ju dëgjoj mirë?

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
15 Shala, prapë nuk e dëgjove dëshmitarin?

16 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Jo, e nderuar, nuk
17 dëgjohet. Dëgjohet përkthimi mbas një kohe kur fillon
18 përkthyesja që përkthen, por gjë nuk dëgjohet dëshmitari.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por
20 duhet të dëgjosh përkthimin, përkthimin duhet të dëgjosh. Për
21 këtë bëhet fjalë. Nuk mund ta dëgjosh dëshmitarin, sepse
22 dëshmitari po flet në një gjuhë që nuk është, nuk është shqip.
23 Dëshmitari nuk po flet shqip. Pra, po e merr me përkthim. Ai
24 po përkthen në gjuhën e vet, edhe nga gjuha e tij, përkthehet
25 në gjuhën shqipe. Nuk është qëllimi që të dëgjoni zërin e tij.

1 Pra, pyetja ime ishte, a merrni përkthimin e asaj që ka thënë
2 dëshmitari.

3 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] E nderuar, unë dëgjoj
4 vetëm një përkthyesë që është duke fol që për mua është
5 përkthim shumë i dobët edhe nga anglishtja në shqip për mua
6 është shumë i dobët. Niveli i përkthimit është shumë i dobët,
7 se unë e kuptoj edhe nga pak edhe anglishten. Por me sa kuptoj
8 unë, e nderuar, me sa kuptoj, edhe ai çeku që ishte më herët,
9 folët çekisht, u ndëgjoke zëni i tina duke fol çekisht, por
10 unë kuptimin e merrshna në gjuhën shqipe. Këtë nuk e dëgjoj
11 fare.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
13 Shala, z. Shala. Nuk është puna të dëgjoni dëshmitarin.
14 Dëshmitari po flet gjuhën polake, polonisht. Duhet të dëgjoni
15 përkthimin, domethënë, a e dëgjoni përkthimin në shqip? Vetëm
16 këtë duhet të dëgjoni ju. Domethënë a e merrni përkthimin në
17 shqip. Ky është qëllimi. Më dëgjoni, më dëgjoni një çast, ju
18 lutem, dëgjoni një çast, ju lutem. Më lejoni të mbaroj
19 fjalinë. Ajo që duhet të dëgjoni ju, pra, ju duhet të merrni
20 përkthimin. Ne do vazhdojmë tani. Do ta testojmë. Ne duam të
21 kuptojmë a merrni përkthimin e asaj që do thotë dëshmitari.
22 Për 3-4 minuta do t'ju pyes edhe një herë, nëse po e merrni
23 përkthimin. Edhe nëse, pra, nëse po e merrni, pas 3-4
24 minutash, do ju pyes, a po e merrni përkthimin apo jo. Ky
25 është qëllimi.

1 Z. Gasior, kam disa këshilla për ju. Pikë së pari, këtu
2 ju kanë thirrur për të dhënë dëshmi para Dhomave të
3 Specializuara të Kosovës në çështjen e Prokurorisë së
4 Specializuar kundër z. Pjetër Shala. Ju do të ndihmoni Trupin
5 Gjykses të marrë vendimin përfundimtar. Ju, tani, do të bëni
6 një deklaratë solemne dhe pasi të bëni deklaratën solemne do
7 t'ju bëjnë pyetje avokatët. Pra, përfaqësuesit e Prokurorisë
8 që janë ngjyrë të vjollctë pastaj përfaqësuesit e Mbrojtësit
9 të Viktimave që janë aty në krah dhe më pas Avokatët Mbrojtës
10 të z. Shala, që kanë togat pjesërisht të kuqe dhe ne Trupi
11 Gjykses. Do të doja t'ju jepja disa këshilla edhe për
12 përgjigjet që duhet të jepni.

13 Z. Gasior, dëgjoni me kujdes secilin nga pyetjet. Nëse
14 nuk e kuptoni lirisht kërkoni që pyetja të përsëritet. Ne duam
15 që të na jepni ekspertizën tuaj me aq sa keni njohuri. Të na
16 jepni mendimet dhe konstatimet tuaja. Ju lutem, përgjigjuni
17 pyetjeve që do t'ju bëjnë. Nëse ne kemi nevojë për më shumë
18 sqarime do ju bëjmë pyetje sqaruese.

19 Z. Gasior, po ashtu do t'ju jap disa këshilla praktike
20 për dëshminë tuaj. Çdo gjë që themi këtu përkthehet dhe
21 regjistrohet. Prandaj është e rëndësishme të flisni afër
22 mikrofonit, të flisni qartë dhe të flisni ngadalë që t'i jepni
23 mundësi përkthyesit t'i përkthejnë të gjitha gjërat që po
24 thuhet.

25 Ju lutem, përgjigjuni vetëm pasi personi që ju ka bërë

1 pyetjen ka përfunduar. Kur t'ju bëjë një pyetje, prisni, po
2 them 10 sekonda dhe pastaj jepni përgjigjen tuaj. Ky pushim,
3 ky 10 sekondësh është shumë i rëndësishëm, sepse na jap
4 mundësinë që të ndjekim ato që ju po thoni.

5 Nëse unë ngre dorën, ndaloni së foluri, sepse po të flas
6 me zë ndërhyj te përkthimi.

7 Mund të ndodhë që ndonjëherë do t'ju kërkojmë të dilni
8 nga salla e gjyqit kur është e nevojshme të diskutohet ndonjë
9 gjë lidhur me përmbajtjen e dëshmisë suaj. Dhe për të mos
10 pasur ndikim te ju, do duhet ta diskutojmë këtë gjë pa praninë
11 tuaj në sallën e gjyqit. Nëse ju keni pyetje apo keni nevojë
12 për pushim apo doni t'i thoni diçka Trupit Gjykses ngrini
13 dorën dhe unë do t'ju jap fjalën.

14 I kuptuat të gjitha këto?

15 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, çdo gjë është qartë,
16 faleminderit.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
18 Shala, e morët, e dëgjuat përkthimin, e morët përkthimin?

19 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] E nderuar, përkthimin e
20 kam marrë, nuk di sa është i saktë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
22 kemi asnjë arsye për ta vënë në dyshim cilësinë e përkthimit
23 të përkthyesve. Por faleminderit dhe herën tjetër, ju lutem,
24 ngrini dorën që të na bëni me dije, thjesht të na thoni që e
25 keni dëgjuar përkthimin.

1 Z. Shala, e dëgjuat pyetjen time? Nuk ju dëgjojmë, z.

2 Shala.

3 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] E ndëgjova, e ndëgjova.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Pajtoheni për këtë?

6 Z. Shala, ndizni, duhet të ndizni mikrofonin, sepse nuk

7 ju dëgjojmë.

8 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] E nderuar Gjyqtare, unë

9 nuk e di çfarë, a pajtona apo s'pajtona --

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

11 lutem, z. Shala. Kisha vetëm një pyetje shumë të thjeshtë dhe

12 një përgjigje e shkurtër.

13 Vetëm ngrini dorën nëse e keni dëgjuar përkthimin,

14 përkthimin e ekspertit, vetëm kaq, ngrini dorën. Kështu do të

15 vijojmë. Ne do të bëjmë të pamundurën që ju ta ndiqni seancën

16 edhe çdo gjë që ka thënë eksperti këtu.

17 Z. Gasior, e morëm parasysh kërkesën tuaj për të sjellë

18 në sallën e gjyqit edhe të përdorni atlasin e anatomisë së

19 trupit të njeriut dhe një kopje fizike të raportit tuaj. E

20 miratua kërkesën për t'i përdorur këto dokumente në sallën e

21 gjyqit. Trupi Gjykes i ka shqyrtuar. Sa i takon raportit

22 duhet t'i kërkon leje Trupit Gjykes përpara se ta përdorni

23 ose të përmendni një pjesë të tij. Të na thoni cilën faqe apo

24 paragraf konkret synoni të përdorni gjatë kohës që do t'ju bëj

25 pyetje; do t'ju bëjnë pyetje palët edhe Mbrojtësi i Viktimave,

1 sepse ne do nxjerrim pjesën konkrete të raportit që ta shohin
2 të gjithë personat.

3 A i kuptuat të gjitha këto, z. Gasior?

4 DËSHMITARI: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, po, i kuptova
5 të gjitha këto që ju sapo thatë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Faleminderit.

8 Z. Shala, ju e dëgjuar përkthimin e asaj që tha
9 dëshmitari?

10 Vetëm mund të, kur të përgjigjeni, ju lutem, ndizni
11 mikrofonin. Në rregull, mjafton. E ngritët gishtin, kështu që
12 kjo do të thotë që ju e keni dëgjuar përkthimin. Shumë mirë.

13 Z. Gasior, do ju lutesha tani të bënit deklaratën solemne
14 dhe ju kujtoj se është vepër penale në juridiksionin e Dhomave
15 të Specializuara të jepni dëshmi të rremë. A i kuptoni këto?

16 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, e kuptoj.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
18 Shala, ju e dëgjuat përkthimin?

19 Ju lutem, mos prisni që t'ju pyes unë çdo herë. Sapo ta
20 merrni përkthimin ngrini dorën, gishtin që të kuptojmë që e
21 keni dëgjuar ne të vazhdojmë.

22 Z. Gasior, ju lutemi përsërisni pas meje.

23 I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime.

24 DËSHMITARI: [Përkthim] A duhet të flas në anglisht?

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

1 polonisht, ju lutem.

2 Pra, i ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime.

3 Z. Shala, e dëgjuat?

4 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Unë nuk dëgjova gjë,
5 nuk di çka, e shoh që lëviz buzët diçka, por nuk ndëgjova
6 asgjë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ta
8 përsërisim edhe një herë. Ta përkthejmë edhe një herë.

9 I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime.

10 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e
11 dëshmisë sime.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
13 dëgjuat këtë fjalinë që sapo lexuam, z. Shala?

14 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Znj. Gjyqtare, unë ju
15 dëgjova ju që shpjeguat, por përsëritjen e fjalëve tina nuk i
16 ndëgjoj.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ne i
18 testuam të gjitha përpara se të rifillonim dhe punonin. Nuk po
19 e kuptoj ku është problemi për momentin. Pra, ju vetëm duhet
20 të na thoni dëgjoni apo nuk dëgjoni, kaq. Ju lutem, z. Shala.

21 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Unë dëgjoj pyetjen e
22 juaj e dëgjova fort mirë dhe përgjigjen, edhe përkthimin e
23 përkthyeses.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
25 Faleminderit. Faleminderit. Tani po lexoj të gjithë deklaratën

1 solemne pasi të merrni përkthimin çdo herë ngritin dorën që ta
2 kuptojmë, çdo herë që e dëgjoni përkthimin, se përndryshe do
3 të zgjasë shumë, siç edhe po e kuptoni. Do të jetë e vështirë
4 që ta kuptojmë. Sepse e kemi përsëritur pesë herë dhe në fakt
5 përkthimin e keni dëgjuar. Nuk duhet të presim shumë gjatë. Do
6 të na ndihmonte shumë që sa herë të dëgjoni përkthimin të bëni
7 shenjë me gisht, që e morët përkthimin.

8 Z. Gasior, vazhdojmë me pjesën e dytë të deklaratës
9 solemne.

10 Dhe përgjegjësinë time ligjore.

11 DËSHMITARI: [Përkthim] Dhe përgjegjësinë time ligjore.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Deklaroj solemnisht.

14 DËSHMITARI: [Përkthim] Deklaroj solemnisht.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Se do
16 të kryej analizën si ekspert në mënyrë të ndërgjegjshme.

17 DËSHMITARI: [Përkthim] Se do të kryej analizën si
18 ekspert, pra, në mënyrë të ndërgjegjshme.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
20 me aq sa di.

21 DËSHMITARI: [Përkthim] Pra, me aq sa di.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
23 se do të jap përfundime.

24 DËSHMITARI: [Përkthim] Pra, edhe një herë, dhe se do të
25 jap përfundime.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
2 mendime të sakta dhe të plota.

3 DËSHMITARI: [Përkthim] Dhe mendime dhe të sakta dhe të
4 plota, pra.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit, z. Dëshmitar. Tani jeni nën betim. Tani do të
7 fillojmë me pyetjet që do t'ju bëjë Zyra e Prokurorit të
8 Specializuar.

9 Znj. Prokurore, keni tre orë në dispozicion. Na thoni
10 nëse keni ndonjë ndryshim lidhur me këtë. Do të mbajnë këtë
11 parasysh sa i takon ritmit që duhet të ndjekim për të siguruar
12 që edhe z. Shala të mund të ndjekë përmes përkthimit. Unë do
13 ta përcjell në ekran në mënyrë që të kuptoj nëse z. Shala e
14 dëgjon përgjigjet e dëshmitarit përmes përkthimit.

15 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Kështu do të veprojmë, patjetër,
16 e nderuar znj. Gjykatëse.

17 DËSHMITARI: MAREK GASIOR

18 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthyesit]

19 Pyetje nga znj. Pergolo:

20 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

21 PY. Mirëdita, doktor Gasior. Sot do t'ju bëj pyetje në emër
22 të Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Do t'ia fillojmë me
23 formimin dhe kualifikimet tuaja, pas së cilës do të vijojmë me
24 disa aktekspertiza të hartuara prej jush të cilat kanë lidhje
25 me këtë çështje gjyqësore.

1 Pjesën më të madhe të këtyre pyetjeve dhe përgjigjeve do
2 t'i bëjmë në seancë publike. Gjithsesi kur të na duhet që të
3 diskutojmë për informacione të mbrojtura do të na duhet të
4 kalojmë në seancë private.

5 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, tani mund
6 të vijojmë në seancë publike.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
8 Prokurore, dëshiroj që ta verifikoj me z. Shala.

9 Z. Shala, i dëgjuat gjithçka që ka thënë znj. Prokurore
10 dëshmitarit? Shumë mirë, në rregull atëherë.

11 Mund të vazhdoni.

12 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit.

13 PY. Z. Dëshmitar, na thoni emrin dhe mbiemrin, ju lutem.

14 PË. Më quajnë Marek, mbiemrin e kam Gasior.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
16 Prokurore, prisni, ju lutem.

17 Z. Shala, a e dëgjuat përkthimin? Ju lutem që ta bëni të
18 ditur me ta dëgjuar në mënyrë që të ndjekim ritmin.

19 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

20 PY. Cila është ditëlindja dhe vendlindja juaj?

21 PË. Kam lindur më datë 20 qershor të vitit 1946 në Brezhin,
22 që është në territorin e Polonisë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 [Mikrofoni çaktivizuar]

25 Z. Shala, unë nuk do t'ju pyes më vazhdimisht. Hë për hë,

1 kam përshtypjen që jeni në rregull me këtë ritëm. Kështu që,
2 ky ritëm duket se funksionin mirë e nëse lind ndonjë problem
3 mund të ngrini dorën edhe mund të na bëni me dije.
4 Faleminderit.

5 Znj. Prokurore, mund të vazhdoni.

6 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

7 PY. Çfarë profesioni ushtroni tani?

8 PË. Hë për hë, pra, zyrtarisht, jam i pensionuar. Jam
9 gjithsesi i regjistruar në listën e ekspertëve të gjykatës së
10 Lublinit, pra në listën e ekspertëve të mjekësisë ligjore. Kjo
11 listë është miratuar nga Kryetari i Gjykatës Rajonale të
12 Lublinit.

13 PY. Sa kohë keni që punoni si ekspert i mjekësisë ligjore në
14 Gjykatën e Rrethit të Lublinit?

15 PË. Si dëshmitar, me cilësinë e ekspertit, punoj në Gjykatën
16 e Rrethit të Lublinit që në vitet '80 kur punoja në Drejtorinë
17 Kriminalistike të Akademisë. Në listën, mandati i të qenit
18 anëtar i listës së ekspertëve zgjatet çdo pesë vjet, me
19 kërkesë të personit të interesuar. Hë për hë, në këtë listë,
20 jam deri në fund të vitit të ardhshëm. Pra, deri në fund të
21 vitit 2024.

22 PY. Faleminderit, Dr. Gasior. Tani puna juaj si ekspert në
23 fushën e mjekësisë mjekësore për Gjykatën e Rrethit të
24 Lublinit, çfarë përfshin?

25 PË. Tani për tani, gjërat me të cilat merrem janë si vijon:

1 më thërret policia në vendin e ngjarjen ku gjenden kufoma për
2 të kryer një këqyrje të jashtme të kufomës për të hartuar,
3 nëse është e mundshme, një opinion paraprak, sa i takon
4 gjërave apo problemeve të ndryshme nëse ka, për shembull,
5 lëndime të dukshme në trupin e pacientit dhe çfarë do të
6 sugjeronin të tilla gjëra.

7 Veç kësaj, trupi i pacientit dërgohet në pikën e
8 mjekësisë ligjore ku kolegët e mi ia kryejnë autopsinë.
9 Zakonisht, unë jam i pranishëm gjatë autopsisë të pacientit
10 tim; autopsi të kryera nga kolegë më të rinj.

11 Krahas këtyre, për gjykatat e jap opinionin tim
12 mbështetur në dosjet e dorëzuara për çështjet penal, por dhe
13 për çështjet civile, duke mbajtur parasysh aspekte të ndryshme
14 të mjekësisë ligjore.

15 PY. Mund t'ju ndërpres tani, sepse mund t'i ridiskutojmë më
16 pas disa prej këtyre aspekteve, por hë për hë dëshiroj që t'ju
17 bëj një tjetër pyetje:

18 Çfarë niveli arsimor keni?

19 PË. Në vitin 1978 kam kryer studimet në Akademinë Mjekësore
20 të Lublinit. Si student, në fakt nuk mund të them se kam
21 punuar atëherë, por kam vendosur kontakte me Akademinë e
22 Mjekësisë Ligjore apo me saktë me Departamentin e Mjekësisë
23 Ligjore në akademi. Dhe kam punuar, fillova të punoja,
24 vazhdova, më falni, punova si ekspert, si asistent në fillim,
25 pastaj pasi bëra dhe specializimin pasuniversitar mora

1 titullin e Ekspertit të Mjekësisë Ligjore, titull të cilin e
2 mbaj edhe sot e kësaj dite. Veç kësaj në Departamentin e
3 Biologjisë të universitetit "Nikola Koperniku" të Torinit në
4 vitin 1996 kam mbrojtur doktoratën në fushën e antropologjisë.
5 Universiteti "Nikola Koperniku" në Toren më dha titullin
6 "Doktor i Shkencave në Biologji dhe Antropologji".

7 PY. Përpara se të punonit si specialist ekspert, pra, i
8 mjekësisë ligjore në Lublin, ju me çfarë pune merreshit?

9 PË. Punoja në Departamentin e Mjekësisë Ligjore. Pra, fillova
10 punë aty pas studimeve të mia; fillova punë në departamentin
11 apo në sektorin këtij departamenti që merret me mjekësinë
12 ligjore, sepse unë kontaktet i kisha vendosur që më përpara si
13 student.

14 Z. AOUINI: [Përkthim] Më falni. Ju kërkoj ndjesë
15 kolegëve. Për transkriptin në faqen 39, rreshti, ishte pa
16 mikrofon, nuk dëgjohet, është fusha e doktoraturës. Aty është
17 shkruar "of tology". Mua m'u duk sikur dëgjova antropologji,
18 por ta korrigjojmë meqenëse jemi këtu.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 [Mikrofoni çaktivizuar] Vura re, biologji dhe antropologji si
21 dy fushat në të cilat e ka marrë doktoratën.

22 Z. AOUINI: [Përkthim] Rreshti 39, më falni, faqja 39,
23 rreshti 19 thotë "of tology".

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po. E
25 mbajtëm shënim. Faleminderit, z. Avokat.

1 Mund të vazhdojmë.

2 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

3 PY. Doktor Gasior, ju lutem na thoni diçka më konkrete sa i
4 takon punës me të cilën jeni marrë nga periudha nëntor 2008
5 deri në nëntor 2012. Ç'punë bënit ju atëherë, gjatë kësaj
6 periudhe, nëse ju kujtohet?

7 PË. Deri në vitin 2008 punoja si ekspert i mjekësisë ligjore
8 për Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Misioni i OKB-së në
9 Kosovë në vitin 2008 u zëvendësua nga Misioni i Bashkimit
10 Evropian dhe në vitin 2008 në të njëjtën vend, pra, në të
11 njëjtin post kam punuar për katër vjet në Bashkimin Evropian.
12 Pra, për Bashkimin Evropian.

13 PY. Ju lutem na shpjegoni shkurtimisht, roli juaq si ekspert
14 i mjekësisë ligjore fillimisht për Misionin e OKB-së dhe
15 pastaj për Bashkimin Evropian, çfarë përfshinte, pra, çfarë
16 veprimtarish kryenit ju si pjesë e këtij posti pune?

17 PË. Sa i takon punës sime për organizatat ndërkombëtare kam
18 filluar në vitin që në vitin 2000. Kam punuar për Tribunalin
19 Ndërkombëtar, TPNJ, pra, Tribunalin Ndërkombëtar për Ish-
20 Jugosllavinë. Këtë punë e fillova në vitin 2000 në morgun e
21 Rahovecit të Kosovës ku kam punuar nga qershori i vitit 2000
22 deri në vjeshtën e atij viti.

23 Në vitin 2001 më kanë dërguar në misionin e Tribunalit të
24 TPNJ-së ku kam punuar në morgun e Visokës pranë Sarajevës e më
25 pas në vjeshtën e vitit 2001 në morgun e Sanski Mostit pranë

1 kufirit të Kroacisë.

2 PY. Do doja që të përqendroheshit në veçanti në përvojën tuaj
3 në Kosovë. Do doja të përqendroheshit te kjo pjesë e punës
4 suaj si ekspert. Pra, shkurtimisht çfarë aktiviteteve apo
5 veprimtarish keni kryer në kuadër të rolit tuaj atje?

6 PË. Në Kosovë kam punuar në pikat e mjekësisë ligjore duke
7 bërë autopsi kufomave njerëzore, pra, dhe autopsi të kufomave
8 të personave të sapovdekur. Gjithashtu kam bërë pjesë në një
9 ekip i cili ka kryer, pra, u ka dhënë trajnim mjekëve të
10 Kosovës të cilëve u ishte ngarkuar detyra për të punuar në
11 pikat përkatëse të mjekësisë ligjore.

12 PY. Faleminderit. Doktor unë e di që ju keni një përvojë
13 shumë të gjerë dhe keni bërë shumë punë të ndryshme në nivel
14 kombëtar dhe ndërkombëtar. Megjithatë, unë nuk do t'ju bëj më
15 pyetje për përvojën tuaj, sepse biografia juaj i është vënë në
16 dispozicion Trupit Gjykues.

17 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Kjo, të nderuar Gjykatës, është
18 në përputhje me paragrafin 61 të urdhrit "Për Zhvillimin e
19 procesit", lidhur me këtë, në përputhje me këtë, ne dëshirojmë
20 që të kërkojmë të pranohet në dokumentacionin gjyqësor dhe CV-
21 ja e ekspertit, biografia e tij, pra, profesionale.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Këtë
23 mund ta bëni më pas në me parashtrim të protokolluar, pra, me
24 shkrim, por jo këtu brenda në sallën e gjyqit.

25 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Kështu do të veprojmë, e nderuar

1 Gjykatëse. Faleminderit.

2 PY. Doktor Gasior, e përfunduar këtë pjesë të parë paraprake
3 sa i takon kualifikimeve tuaja. Dëshiroj që të diskutojmë së
4 bashku për disa aktekspertiza të cilat ju i keni përpiluar në
5 të shkuarën dhe të cilat kanë lidhje me këtë proces gjyqësor.

6 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ju lutemi
7 që në ekran të paraqesim raportin e parë, dokumentin e parë me
8 qëllim që dëshmitari të vërtetojë origjinalitetin e tij. Mund
9 t'ju jap edhe numrin e ERN-së.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
11 patjetër, mundet.

12 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Është me numër 031049 deri në
13 031095 RED2. Ky dokumentin nuk duhet t'i transmetohet
14 publikisht.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Faleminderit. Znj. Sekretare, ju lutem, shfaqeni në ekran.

17 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nëse mundet
18 dëshiroj të kalojmë në seancë private, shkurtimisht, për të
19 folur për disa informacione të mbrojtura.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Patjetër. Znj. Sekretare, ju lutem, na kaloni në seancë
22 private.

23 [Seancë private]

24 [Seancë private teksti i fshirë]

25

Dëshmitari: Marek Gasior (Seancë private)
Pyetje nga znj. Pergolo

Faqe 47

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7 [Seancë e hapur]

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
9 jemi rikthyer në seancë publike.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit znj. Sekretare.

12 Znj. Prokurore, ju lutem, vazhdoni.

13 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

14 PY. Doktor Gasior, a e keni përgatitur ju këtë dokument?

15 PË. Po, unë e kam përgatitur.

16 PY. Nëse shohim faqen 4 dhe i lutem znj. Sekretare nëse është
17 e mundshme. Në fakt është një faqe përpara faqes që kemi tani
18 në ekran faqja e mëparshme.

19 A e njihni nënshkrimin në këtë faqe?

20 PË. Po, e njoh. Është nënshkrimi im.

21 PY. E keni bërë ju vetë këqyrjen e përshkruar në këtë
22 dokument?

23 PË. Në çdo rast të çdo autopsie e kam kryer unë vetë këqyrjen
24 e pacientit dhe këtë e kam bërë në mënyrë që të konstatoj
25 lëndimet. Dhe kjo ka ndodhur edhe në këtë rast.

1 PY. Doktor Gasior, a mund të na shpjegoni ju lutem se cila
2 ishte, cili ishte qëllimi i këqyrjes apo autopsisë që keni
3 kryer në këtë rast konkret? Na e shpjegoni ju lutem.

4 PË. Puna në morg ishte e tillë që unë si çdo kolegu im, çdo
5 person ekspert mjekoligjor, merrnim qese plastike, qese me një
6 numër konkret. Domethënë, qesja në vetvete kishte një numër
7 identifikues dhe nuk asnjëherë nuk e dimë se çfarë ka brenda
8 ajo qesja, domethënë, çfarë lënde ka brenda qesja. Dhe
9 pacienti në këtë qese, së pari, pra, kur u soll qesja në
10 departamentin mjekoligjor, së pari, u dërguan tek ajo çfarë ne
11 e quajmë dhomë e ftoftë ose dhomë frigoriferike dhe priste që
12 t'i vinte radha. Dhe prej aty, prej dhomës frigoriferike u
13 dërguan në një tjetër dhomë; në një dhomë ku kishin aparaturat
14 me rreze iks në mënyrë të tillë që të bëheshin këqyrjet dhe
15 kontrollet përkatëse. Dhe të shihej në qoftë se kishte pjesë
16 metalike të cilat mbase kishin mbetur në trupin e personit. Në
17 rastin në fjalë, nga shënimet rezulton se nuk ka pasur asnjë
18 copëz apo pjesë metalike të gjetur në trupin në fjalë. Këqyrja
19 ose ekzaminimi me aparatura, me rreze iks, skanimi në vetvete,
20 pra, nuk ka treguar që kishte të pranishme pjesëza metalike të
21 mbetura në trup edhe për këtë arsye nuk janë bërë fotografi.

22 PY. Le t'i marrim hap pas hapi të gjitha këto. Domethënë,
23 përpara sesa t'ju bëj disa pyetje të tjera që të na e
24 shtjelloni më tepër shpjegimin që sapo dhatë, më lejoni që
25 t'ju bëj disa pyetje të tjera graduale, hap pas hapi.

1 Ju sapo përmendët që në këtë rast, pra, puna në morg në
2 këtë rast dhe për referencë kjo jepet në transkript në faqen
3 44, në rreshtin nga 4 [sipas përkthimit] deri në 25. Dhe thatë
4 që morët një qese plastike me një numër konkret edhe që nuk e
5 dinit se çfarë kishte aty brenda qeses plastike.

6 Pyetja ime është kjo: A keni marrë ndonjë informacion
7 rreth këtij individi apo a keni marrë ndonjë informacion që ka
8 të bëjë me arsyet pse ky person ishte dërguar atje, domethënë,
9 a keni marrë informacion përpara sesa të merrnit këtë qesen
10 plastike me mbetjet e trupit të njeriut; a dinit gjë lidhur me
11 këtë rast përpara sesa të vinte qesja?

12 PË. Duke qenë se kam punuar në morg, unë thjesht, ajo çfarë
13 mora ishte një qese plastike me një numër sipër.

14 PY. Kur keni kryer autopsinë, a keni ndjekur ndonjë protokoll
15 konkret apo a keni ndjekur ndonjë udhëzim konkret që
16 ekzistonin në morg në atë kohë kur ju keni punuar atje?

17 PË. Metodologjia e punës së kryer përcaktohej në vitin 2000.
18 Domethënës, kishte një metodologji të përcaktuar që në vitin
19 2000 në morgun e Rahovecit, në Visoko. Dhe sa i takon kësaj
20 metodologjie në këtë metodologji, kemi mundur që të ndjekim
21 edhe gjatë punës në Prishtinë.

22 PY. Faleminderit, Doktor Gasior.

23 Ju na thatë përsëri, dhe kjo për procesverbal jepet në
24 faqen 45, rreshtat 5 deri në 6. Ju thatë që u dërguan në
25 dhomën frigoriferike dhe prej aty trupi u çua për t'u skanuar,

1 pra, për t'u kaluar në pajisjet skanuese. Pastaj vazhduat duke
2 na dhënë rezultatet e kësaj analize skanuese.

3 Ju lutem, a mund ta nisni nga këtu dhe të na thoni edhe
4 një herë, se çfarë tregoi ky ekzaminim ose çfarë tregoi ky
5 proces i kalimit të trupit në skaner?

6 PË. Skaneri që ne kemi përdorur në Prishtinë ishte një
7 pajisje fluoroskopike, pajisje që të lejonte që të përcaktoje
8 në qoftë se në trupin e shqyrtuar ose të këqyrur kishte mbetje
9 metalike. Në praktikë, ajo çfarë ndodhte ishte që të trupi së
10 bashku me këtë qesen plastike ku ishte vendosur trupi çohet në
11 skaner dhe pastaj bëhet vlerësimi ose ekzaminimi nga skaneri.
12 Dhe në qoftë se nuk detektohet asnjë copë metalike nga skaneri
13 nuk bëhet asnjë fotografi, por në të kundërtën, në qoftë se
14 gjendej prania e një pjesëze ose copëze metalike në trupin e
15 personit atëherë bëhet fotografi edhe fotografia zbardhet
16 pastaj për si pjesë e procedurës së autopsisë.

17 PË. Faleminderit. Besoj se na e përmendët edhe pak më herët
18 dhe kjo jepet në faqen 45, në rreshtat nga 9 deri në 10. Pra,
19 e thatë edhe më përpara që në këtë rast skaneri nuk tregoi që
20 kishte mbetje të një copëze metalike në trupin që shqyrtuat
21 apo këqyrët ju, kështu?

22 PË. Në raportin tim, pra, jepet një shënim ku thuhet që i
23 gjithë trupi iu nënshtrua një ekzaminimi me rreze X, ose një
24 ekzaminimi me skaner dhe nuk u gjet asnjë copëz apo as pjesëz
25 metalike ose ndonjë copëz e ndonjë plumbi apo ndonjë predhe.

1 PY. Pas ekzaminimit me skaner dhe pastaj kur filluat juve
2 këqyrjen ose ekzaminimin tuaj në çfarë gjendje ishte trupi? Në
3 momentin që të bënit ekzaminimin tuaj si ekspert mjekoligjor.
4 Në çfarë gjendje ishte trupi?

5 PË. Trupi u lëviz dhe u dërgua në tryezën e autopsisë. Pra,
6 në vendin ku bëhet autopsia. I gjithë ekipi i ekspertëve e
7 këqyrën, e ekzaminuan trupin. I pranishëm ishte edhe një
8 fotograf. Fotografi bënte fotografi. Përpara sesa të bëhej
9 autopsia, gjatë autopsisë edhe pas autopsisë. Ekipi që bëri
10 autopsinë në fjalë, pra, bëhej fjalë për një ekzaminim pas
11 vdekje dhe ekipi përbëhej nga një fotograf, nga antropolog,
12 përbëhej ndonjëherë, domethënë, edhe nga asistenti i
13 antropologut dhe ndonjëherë ishin të pranishëm edhe një
14 ndihmës i fotografit. Zakonisht ishte i pranishëm edhe një
15 oficer policie, i cili bënte një listë të të gjitha provave
16 materiale apo të artefakteve të konstatuara bashkë me trupin.
17 Ndërkohë që sa i takon antropologut, antropologu ndihmonte për
18 përcaktimin e moshës së gjinisë dhe staturës ose formave të
19 trupit të personit në fjalë. Dhe kur hiqeshin inde nga trupi
20 ne shikonim në qoftë se kishte dëmtime apo lëndime të indeve
21 apo të kockave në mënyrë të tillë që të përcaktonim më pas se
22 cili ishte shkaku i vdekjes.

23 Unë merrja zakonisht një raport nga antropologu, po ashtu
24 merrja një raport edhe nga oficeri i policisë, merreshin edhe
25 fotografitë e bëra nga fotografi mjekoligjor dhe mbi bazën e

1 këtyre dhe të konstatimeve të mia duhej që të shkruaj një
2 raport përfundimtar, ku mendohej që unë të jepja shkakun e
3 vdekjes.

4 Kështu ndodhi edhe në rastin në fjalë. Pra, edhe në
5 rastin që po diskutojmë bashkërisht, kështu ka ndodhur.

6 PY. Ju lutem, a mund të na përshkruani ndoshta do të shikojmë
7 disa prej fotografive që kanë shoqëruar raportin, por na e
8 përshkruani me pak fjalë se në çfarë gjendje ishte trupi në
9 momentin kur e patë trupin? Çfarë karakteristikash vutë re në
10 trup kur e këqyrët atë?

11 PË. Në përgjithësi, raporti përmban disa krerë. Në kreun e
12 parë jepet një përshkrim i përgjithshëm i trupit, i eshtrave,
13 i çfarë ka mbetur nga trupi, në atë çfarë është brenda në
14 qesen plastike. Në rastin konkret, në këtë qesen plastike,
15 mbetjet e trupit apo eshtrat e trupit ishin, i takonin vetëm
16 një personi. Pra, ishin eshtrat e një personi të vetëm. Ato
17 ishin në një fazë tranzitore, atë që ne e quajmë saponifikim.
18 Ky është termi që përdorim për këtë fazë dhe ky është
19 transformimi kur kockat bëhet si të buta në trajtë sapuni dhe
20 prandaj quhet procesi i saponifikimit.

21 PY. Pjesa ose ndoshta ky procesi i saponifikimit ka të bëjë
22 me dekompozimin e trupit, a mund të na e shpjegosh pak për ta
23 kuptuar më mirë?

24 PË. Po. Ky proces i cili quhet procesi i saponifikimit,
25 sikurse e shpjegova edhe më sipër, mund të ndodhë kur eshtrat,

1 mbetjet gjenden në një mjedis të lagësht, zakonisht në
2 temperatura të ulëta dhe pa praninë e oksigjenit. Ky proces
3 ndonjëherë ndodh kur eshtrat janë në një mjedis të lagësht në
4 ujë ose kur janë në kushte ose në një mjedis që është mjedis i
5 lagësht. Dhe në mënyrë që të ndodhë procesi i sapunifikimit të
6 eshtrave, të trupit të vdekur, ne kemi këtë pjesën e
7 transformimit të trupit të personit, i cili kërkon ca kohë.
8 Kështu që në mjekësinë ligjore prezumohet që kjo periudhë
9 duhet të zgjasë për të paktën gjashtë muaj. Mund të jetë edhe
10 më gjatë, sesa kaq.

11 PY. Faleminderit, doktor Gasior. Kam një pyetje lidhur me atë
12 çfarë na shpjeguat deri tani. Juve na shpjeguat se çfarë ndodh
13 gjatë procesit të sapunifikimit. Dëshiroj t'ju pyes në qoftë
14 se ka pasur inde të tjera që keni këqyrur ju. Dhe me inde e
15 kam fjalën këtu, domethënë, në qoftë se keni marrë ndonjë
16 pjesë të lëkurës apo të enëve të kalimit të gjakut ose ndonjë
17 gjë tjetër, domethënë, keni marrë ndonjë fragment tjetër nga
18 trupi për ta ekzaminuar?

19 PË. Në një gjuhë të zakonshme, në mjekësinë ligjore, ne e
20 quajmë këtë transformimin në shkumës. Pse? Sepse mbetjet janë
21 të bardha dhe janë shumë të brishta, dhe copëtohen shumë
22 kollaj si shkumësi. Dhe asnjëherë nuk ndodh që të gjitha
23 organet të transformohen ose të dekompozohen në një mënyrë
24 konkrete. Domethënë, ka modele nga më të ndryshmet ose format
25 nga më të ndryshmet. Megjithatë, në rastin konkret, sikurse

1 mund ta shikoni dhe nëpërmjet fotografie, i gjithë trupi apo
2 të gjitha indet e butë të trupit ishin të sapunifikuara.

3 PY. Faleminderit për përgjigjen. A gjetët ndonjë gjë tjetër
4 në trupin e personit? Domethënë, përveç pjesës së kockave që
5 ishin në gjendjen që sapo na përshkruat, a konstatuat apo a
6 gjetët ndonjë gjë tjetër në trupin e personit të vdekur që
7 mund të na e shpjegoni neve?

8 PË. Po. Rroba, tesha të cilat ishin siguruar nga oficeri i
9 policisë që kishte qenë në terren, nga ku ishte marrë trupi.
10 Përveç kësaj, në anën e majtë të këmbës, në gjymtyrën e majtë,
11 në fund të gjymtyrës së djathtë ishte gjetur gjithashtu edhe
12 një copë, pra, ishte gjetur, u gjet një objekt gjithashtu në
13 këmbën e djathtë dhe ne e hoqëm këtë. Një copë si allçi. Ne e
14 hoqëm atë dhe më pas morëm gjithashtu edhe një fragment të
15 indeve të buta. Ndërkohë, kockat i vendosëm në një pozicion
16 anatomik dhe u mbajtën në një pozicion të tillë për t'i
17 këqyrur në mënyrë vizuale. Pra, për t'i këqyrur ata për të
18 parë gjëra që nuk shkonin.

19 PY. Doktor Gasior, dëshiroj tani t'ju tregoj disa prej
20 fotografive të bëra në raport që janë pjesë e raportit dhe do
21 t'ju kërkoj që të konfirmoni konstatimet tuaja.

22 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të
23 shfaqet në ekran faqen që ka numrin ERN 031056. Mbase është,
24 nëse s'gabohem faqja 5 e raportit.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

1 lutem, transmetojeni, paraqiteni në ekran këtë faqe, znj.

2 Sekretare.

3 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Zmadhojeni pak, ju lutem

4 PY. Doktor Gasior, kjo fotografi a tregon trupin e personit

5 bashkë me rrobat që ju përmendët pak më përpara?

6 PË. Sipas përshkrimit, eshtrat apo mbetjet e trupit të vdekur

7 ishin bashkë me rrobat, ishin brenda rrobave. Kjo është pjesa

8 e jashtme ose pamja e jashtme. Ndërkohë që në këmbën, në të

9 djathtë, mund të shikoni këtë pjesën e allçisë që e përmenda
10 pak më përpara.

11 PY. Në rregull. Mbase për të na ndihmuar për ta kuptuar më

12 mirë në mënyrë që të mund të shikojmë këtë këmbën e djathtë, a

13 është e mundur që të paraqitet në ekran dokumenti tjetër,

14 faqja tjetër, që është dokumenti me numër ERN-je 3031057

15 [sipas përkthimit].

16 Kjo është një fotografi nga pjesa e pasme e kufomës, e
17 saktë është kjo?

18 PË. Po, është pamja e marrë nga pas. Ne shohim shpinën,

19 pjesën e pasme.

20 PY. Doktor Gasior, na treguat që keni gjetur një allçi dhe

21 kjo jepet në faqen 49, domethënë, janë rreshtat 12, 13, një

22 copë gipsi që më pas e hoqët.

23 Ju lutem, a mund ta shënjoni në këtë fotografi, se ku

24 gjendej ky material?

